

UDHËZIM

Për procedrën e prokurimit për furnizimin me karburant gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje,

Agjencia e Prokurimit Publik, bazuar shkronjën d, të pikës 2 të nenit 13 të Ligjit nr.9643, date 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, duke marrë shkas nga një numër i madh kërkesash për interpretim, lidhur me rrugët ligjore për të realizuar procedurën e prokurimit për furnizimin me karburant gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, si rrjedhojë e dështimit për mungesë konkurrence, të procedurës së prokurimit “Tender i hapur ndërkombëtar”, të kryer nga Njësia e Prokurimeve të Përqendruara pranë Ministrisë së Brendshme,

Udhëzon:

1. Sipas VKM nr.821, date 18.06.2008 “Për një përjashtim nga VKM nr.53, datë 16.01.2008 “Për ngarkimin e Ministrisë së Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik, për disa mallra dhe shërbime në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive dhe institucioneve të varësisë””, përjashtimisht, **për gjithë vitin kalendarik 2008, procedurat e prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje kryhen nga vetë autoritetet kontraktore.**

Çdo autoritetet kontraktor duhet të vlerësojë situatën, në të cilën ndodhet, nevojat për furnizimin me karburant për vitin 2008 dhe të varësi të fondit limit të realizojë vetë procedurën përkatëse të prokurimit, që do të përzgjedhë sipas dispozitave ligjore dhe nënligjore të prokurimit publik.

2. Gjithashtu, në procedurat e prokurimit për furnizimin me karburant, çdo autoritetet kontraktor duhet të mbajë parasysh VKM nr. 822, date 18.06.2008, “Për disa shtesa në Vendimin nr.1, date 10.01.2007 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullave për Prokurimin Publik (të ndryshuar)””, I cili parashikon se:

“Kriter vlerësimi për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje do të jetë çmimi më i ulët, bazuar në:

- i) çmimin e bursës, sipas Reuters lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për botim, çdo javë, në Buletinin e Njoftimeve Publike nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;

- ii) elementet fiskale, përfshi akcizën, taksë karboni;
- iii) marzhin e fitimit, të shprehur në vlerë absolute dhe në përqindje.

Nëse çmimi, gjatë kohës së zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant, gazoil, benzol, dhe karburant për ngrohje, sipas Reuters, ndryshon dukshëm në ulje apo ngritjen, me kërkesën me shkrim të palëve dhe në varësi të çmimeve të ndryshueshme të blerjes në tregjet ndërkombëtare, kontraktori pasqyron, në faturat periodike të shitjes, çmimin e mallit, të mbështetur në deklaratën doganore SAD.

Autoriteti kontraktor, para pagimit të faturës së mallit duhet të kontrollojë përqindjen, e rritjes apo uljes, të çmimit të bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, cilësinë e mallit të lëvruar, nëse është e njëjtë me atë të premtuar në ofertë.

Çdo autoritet kontraktor do të gjejë të publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike, çmimin e bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Agjencinë e Prokurimit Publik.

Në faqen e internetit të APPdo të gjeni ndryshimet përkatëse të pasqyruara në dokumentet standarde të tenderit.

3. Aktualisht, gjatë periudhës deri në lidhjen e kontratave të reja pas realizimit të procedurave normale të prokurimit nga ana juaj, ju udhëzojmë që autoritetet kontraktore *duhet të shfrytëzojnë të gjitha hapësirat ligjore që parashikon legjislacioni aktual i prokurimit publik për plotësimin e nevojave emergjente*. Pra, autoriteti juaj kontraktor duhet të vlerësojë rrethanat dhe kushtet, në të cilat ndodhet. Në rast se arrihet të argumentohet emergjenca, atëherë, autoriteti juaj kontraktor mund t'i referohet nenit 33/2/c të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Për prokurimin publik" (me ndryshime). Në këtë dispozitë, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit, *kur për arsye të nevojës ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor, afati kohor i parashikuar në nenin 43 të ligjit 9643, datë 20.11.2006 për njoftimin e kontratës për procedurat e hapura, të kufizuara ose me negociim, me publikim, nuk mund të respektohet*. Rrethanat e përmendura për të justifikuar nevojën ekstreme nuk duhet të shkaktohen në asnjë rast nga veprimi ose mosveprimi i autoritetit kontraktor. Kushtet dhe rrethanat e përdorimit të kësaj procedure përcaktohen në rregullat e prokurimit.

Në këto kushte, autoritetet kontraktore duhet të procedojnë sipas dispozitave ligjore të cituara mësipër, duke bërë të mundur në këtë mënyrë plotësimin e nevojave përkatëse

D R E J T O R
Klodiana CANKJA
Ne mungese dhe me porosi
ZV/DREJTOR

Anilda SEFGJINI